



Pranimar / Dorezuar Priljezni/Prilidato Received/Delivery	28.09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SEP/MSH/KC	5713/2022		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.714/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.714/2022 të datës 18.08.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi: [redacted] kundër Vendimit Nr.01/2022 të Komisionit Vlerësues Brenda Kategorisë të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 16.08.2022, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.09.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.714/2022 e datës 18.08.2022 e parashtruara nga ankuesi [redacted]
- II. MBETET në fuqi Vendimit Nr.01/2022 të Komisionit Vlerësues Brenda Kategorisë të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 16.08.2022.

A r s y e t i m

Ministria e Mbrojtjes me datë 15.06.2022 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: RN00009195 për pozitën e punës: "Zyrtar për Raporte dhe Analiza" në kuadër të Departamentit/Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes, ndërsa sipas shkresave të lëndës në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo sipas njoftimit të datës 09.08.2022 rezultoi se i njëjti nuk është kandidati i suksesshëm.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.01/2022 të Komisionit Vlerësues Brenda Kategorisë të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 16.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 18.08.2022 dhe numër protokoll:4796/2022 me pretendimet ankimore se Komisioni i Vlerësimit nuk e ka vlerësuar mjaftueshëm në intervistën me gojë ndërsa nuk e kundërshton vlerësimin për kandidaten e

suksesshëm, me arsyetimin se akti i goditur me këtë ankesë përmban shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa Këshilli me datë 31.08.2022 ka pranua përgjigjen në kërkesë me numër protokolli:5052/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 18.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Drejtorit të Departamentit për Politikat e Personelit i datës 15.07.2022; Vendimin e Drejtorit të Departamentit për Politikat e Personelit i datës 25.07.2022; E-mailin e dërguar nga sistemi SIMBNJ i datës 09.08.2022; Ankesa e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë; Vendimin Nr.01/2022 të Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë i datës 16.08.2022; Formularët e vlerësimit të intervistës nga Komisioni për ankuesin për pozitën Zyrtar për Raporte dhe e Analiza; Formularin e regjistrimit të ankesës në Këshill i datës 18.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.08.2022; Përgjigje në kërkesë me shkresat e lëndës e datës 07.09.2022 me numë prot:5149/2022; Aplikacionin e datës 06.07.2022 të kandidatës fituese Vlorë Çertifikatën e datës 30.07.2013; Çertifikatën e datës 03.03.2015; Çertifikatën e datës 16.02.2016; Çertifikatën e datës 10.03.2022; Akt emërimit e datës 15.12.2015 me numër:6888; Akt emërimit e datës 01.12.2014 me numër:7078; Vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të AUV-së i datës 23.01.2020; Vendimin e Zv/Drejtorit Ekzekutiv të AUV-së i datës 29.09.2020; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatës fituese; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 05.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 08.01.2021; Vërtetimin e datës 05.07.2022 lëshuar nga Menaxheri i Personelit në AUV; Aplikacionin e ankuesit të datës 07.07.2022; Çertifikatën e datës 04.10.2013 lëshuar nga Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës; Çertifikatën e datës 15.06.2015 lëshuar nga Dekani i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës; Vërtetimin mbiu përvojën e punës i datës 03.06.2015; Vërtetimin e datës 08.12.2014; Akt emërimit e ankuesit i datës 30.01.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 25.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 30.12.2022; Vërtetimin e datës 31.05.2022; Njoftimin përfundimtare për kandidaten fituese i datës 17.08.2022; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për ankuesin; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për K.M; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për M.L; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për I.M; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për A.B; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga J.B për V.R-G; Njoftimin për kandidaten fituese i datës 09.08.2022; Raporti i Komisionit vlerësues për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza i datës 05.08.2022; Formularët e vlerësimit të intervistës nga Komisioni për kandidaten fituese për pozitën Zyrtar për Raporte dhe e Analiza; Pyetjet lidhur me intervistën me gojë për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza; Orarin për intervistim i datës 05.08.2022; E-mailin e datës 03.08.2022 dërguar nga S.H për kandidatët në procedurën rekrutuese; Listën e aplikantëve me numër refrence:RN00009195; Njoftimin e lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit i datës 15.07.2022 për kandidatin Sh.I; Njoftimin e lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit i datës 15.07.2022 për kandidatin

A.M; Njoftimin e lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit i datës 15.07.2022 për kandidatin B.P; Njoftimin e lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Politikat e Personelit i datës 15.07.2022 për kandidatin B.B; Listën e kandidatëve në pritje me numër reference: RN00009195; Konkursin e datës 15.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza"; Vendimin e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 21.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses sikurse dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas aplikacionit të datës 07.07.2022 ka aplikuar konkursin e datës 15.06.2022 me numër të Referencës: RN00009195 për pozitën e punës: "Zyrtar për raporte dhe analiza" në kuadër të Departamentit të Politikave të Mbrojtjes të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa sipas raportit të i datës 05.08.2022 i hartuar nga Komisionit vlerësues, ankuesi nuk ka arritur të jetë kandidati fitues. Ankuesi kundër njoftimit të datës 09.08.2022 për kandidatin fitues ka parashtruar ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, ndërsa me datë 16.08.2022 Komisionin për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë ka nxjerrë vendimin më numër:01/2022 përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 11.08.2022.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore te ankuesit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 47 paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës", ndërsa në shkresat e lëndës të Kolegji ka gjetur se Komisionin për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë ka hartuar listën prej pesë (5) pyetjes të njëjta për të gjithë kandidatët në procedurë dhe mbi këtë bazë është konstatuar se Komisioni Vlerësues ka vepruar sipas mandatit ligjor i cili ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit me nenin 47 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit gjatë analizimit të Formularëve të vlerësimit të intervistës me gojë për ankuesin, ka gjetur se gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues (KVLBK) ankuesin e kanë vlerësuar sipas bindjes së lirë gjegjësisht asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk e ka vlerësuar në mënyrë të njëjtë, ndërsa ankuesi nga Komisioni Vlerësues ka marr gjithsejtë 65.4 pikë nga vlerësimi i përbashkët dhe me këtë rast Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë ka vepruar në pajtueshmëri me paragrafi 4 të nenit 47 si dhe paragrafin 1 dhe 2 i nenit 48 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë. Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mblidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mblidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit", ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, pasi që ankuesi nuk e ka mbështetur me asnjë provë pretendimin e tij se pse është dashur të vlerësohet me shumë, madje i njëjti nuk e kundërshton vlerësimin dhe

përzgjedhjen e kandidatës fituese, mirëpo i njëjti ngre paralele mes intervistave të tjera dhe intervistën për pozitën në të cilën ka aplikuar në këtë konkurs.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë me rastin e nxjerrjes së vendimit Nr.01/2022 të datës 16.08.2022 ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që në pjesën hyrëse të vendimit askund nuk i është referuar dispozitat të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sikurse nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin në fjalë, konstaton se ky pretendim ligjërish është i pa bazuar pasi që lidhur me ankesat dhe afatet ankimore për procedurat e lëvizjes brenda kategorisë, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nuk përcakton afatet kohore të trajtimit të ankesave, mirëpo kjo çështje është e rregulluar me Rregulloren Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e cila është nxjerrë në mbështetje të nenit 38 paragrafi 7 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar ngase Vendimi Nr.01/2022 të datës 16.08.2022 i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ në kuptim të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit të datës 11.08.2022 Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit refuzohen si të pabazuara sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna në pasqyrimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.714/2022 e datës 18.08.2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Arkivit të KPMSHCK-së